



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Inputi për Raportin e Progresit**

**Prill 2012**  
**PRISHTINË**

TABELAT.....	2
LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE .....	2
HYRJE.....	5
<b>1. KRITERET POLITIKE.....</b>	<b>6</b>
<b>1.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT.....</b>	<b>6</b>
1.1.1. <i>Institucionet</i> .....	7
1.1.2. <i>Parlamenti / Zgjedhjet</i> .....	7
1.1.3 <i>Administrata Publike</i> .....	7
1.1.4. <i>Sistemi gjyqësor</i> .....	8
1.1.5. <i>Politikat Kundër Korrupsionit</i> .....	9
<b>1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE .....</b>	<b>9</b>
1.2.1 <i>Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</i> .....	9
1.2.2. <i>Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve</i> .....	9
1.3. <i>Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare</i> .....	10
<b>2. KRITERET EKONOMIKE.....</b>	<b>11</b>
<b>2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT .....</b>	<b>11</b>
2.1.1. <i>Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike</i> .....	11
2.1.2. <i>Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese</i> .....	13
2.1.3. <i>Funksionimi i tregjeve të produkteve</i> .....	14
2.1.4. <i>Spektori financiar</i> .....	15
<b>2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT BRENDA UNIONIT.....</b>	<b>16</b>
2.2.1. <i>Kapitali Njerëzor dhe Fizik</i> .....	16
2.2.2. <i>Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit</i> .....	17
2.2.3. <i>Zhvendosjet strukturore në ekonomi</i> .....	17
2.2.4. <i>Intervenimet e Qeverisë në ekonomi</i> .....	18
2.2.5. <i>Integrimi tregtar</i> .....	18
<b>3. STANDARDET EVROPIANE .....</b>	<b>19</b>
<b>3.1. TREGU I BRENDSHËM .....</b>	<b>19</b>
3.1.1 <i>Lëvizja e Lirë e Mallrave</i> .....	19
3.1.2. <i>Lëvizja e Lirë e Kapitalit</i> .....	19
a. <i>Doganat</i> .....	20
b. <i>Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)</i> .....	20
3.1.3. <i>Doganat dhe Tatimet</i> .....	21
3.1.4. <i>Prokurimi Publik</i> .....	21
3.1.5. <i>Punësimi dhe Politikat Sociale</i> .....	21
3.1.6. <i>Arsimi dhe Hulmtimi</i> .....	22
<b>3.2. POLITIKAT SEKTORIALE .....</b>	<b>23</b>
3.2.1. <i>Industria dhe NVM-të</i> .....	23
3.2.2. <i>Bujqësia dhe Peshkataria</i> .....	23
3.2.3. <i>Siguria Ushqimore dhe Veterinaria</i> .....	23
3.2.4. <i>Mjedisi</i> .....	24
3.2.5. <i>Politikat e Transportit</i> .....	25
3.2.6. <i>Energjia</i> .....	25
3.2.7. <i>Shoqëria Informativë dhe Media</i> .....	26
3.2.8. <i>Kontrolli Financiar</i> .....	26
3.2.9. <i>Statistikat</i> .....	27
<b>3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA .....</b>	<b>27</b>
3.3.1. <i>Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi</i> .....	27
3.3.2. <i>Pastrimi i Parave</i> .....	28
3.3.3. <i>Policia dhe Luftimi i Krimit të Organizuar</i> .....	28
3.3.4. <i>Mbrojtja e të dhënave personale</i> .....	29

## TABELAT

<i>Tabela 1 - BPV nominale dhe rritja e saj reale .....</i>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>	29
<i>Tabela 2 - Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm, në miliona euro dhe si % në GDP .....</i>		29
<i>Tabela 3 - Ndryshimi vjetor në % i ICK dhe në ICK bazë.....</i>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>	30
<i>Tabela 4 - Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të nivelit komunal dhe qendror janar-shkurt 2012 .....</i>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>	0
<i>Tabela 5 - Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV.....</i>		30

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AGPK	Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Kosovës
AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKK	Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKS	Agjencia Kosovare për Standarde
AMPM	Antemortum – Postmortum
ANP	Aerporti Ndërkombëtar i Prishtinës
ANVM	Agjencioni për Ndërrmarjet e Vogla dhe të Mesme
APIK	Agjencioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ARBK	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore ( <i>Central European Free Trade Agreement</i> )
DAK	Drejtoria e Akreditimit të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DK	Doganat e Kosovës
DMNV	Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
DMRAP	Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike
DPI	Departamenti i Pronësisë Intelektuale
ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit ( <i>European Common Aviation Area</i> )
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FADN	Rrjeti i te Dhënave për Kontabilitetin e Fermave ( <i>Farm Accountancy Data Network</i> )
FET	Fondacioni European per Trajnime
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDDS	General Data Dissemination Standard
GND	Grupi Ndërmintor për Decentralizim
GP	Grupi Punues
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFS	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IGjK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IHH	Indeksi Herfindalh - Hirschman
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IOM	Organizata ndërkombëtare e Migrimit ( <i>International Organization for Migration</i> )
IPA	Instrumenti për asistencë të Para Anëtarësimin
IPN	Instituti për Produktet e Ndërtimit

KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi/et Komunal/e
KKDFE	Kompania Kosovare e Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike
KKK	Korniza e Kurrikulumi të Kosovës
KNRAP	Komiteti Ndërmintor për Reformën e Administratës Publike
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPGjP	Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPK	Komisioni Prokurorial i Kosoves
KPMM	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
KQP	Komisioni Qeveritar për Privatizim
KQPZh	Komisioni Qendror për Persona të Zhdukur
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEK	Menaxhimi i Financave të Kontrollit
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës dhe Sigurisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
ML	Ministritë e Linjës
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPF	Monitorimi i Punës së Fëmijëve
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZhe	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NjDNjK	Njësia për të Drejtat e Njeriut të Komunave
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEAK	Oda Ekonomik Amerikane e Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJQ	Organizatata Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PFAL	Programi Fillestar për Arsimim Ligjor
PK	Policia e Kosovës

PKK	Pika e Kalimit Kufitar
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
PSH	Prokuroria e Shtetit
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
PTB	Projekti Tam/Bas
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVAL	Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës
PZhBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
RAP	Reforma e Administratës Publike
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SEECCEL	South East European Center for Entrepreneurial Learning
SEMSF	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik
ShKCAK	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SISh	Sistemi Informimin Shëndetësor
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve
SMC	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
SMP	Staff Monitored Program
SPVKK	Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër-Korrupcion
TAIEX	Asistencë teknike dhe shkëmbim i informacionit ( <i>Technical Assistance and Information Exchange</i> )
TVK	Trupa e Vlerësimit për Standarde
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara ( <i>United Nations Development Programme</i> )
UNHCR	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë ( <i>Office of the United Nations High Commissioner for Refugees</i> )
USAID	United States Agency for International Development
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZÇK	Zyra për çështje të komuniteteve
ZKK	Zyra për Kthim dhe Komunitete
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPI	Zyra për Pronësi Industriale
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

## **Hyrje**

Ky raport përmban zhvillimet kryesore në Kosovë nga 1 janari 2012 deri në 30 mars 2012, përkatësisht përfshinë kuartalin e parë (K1) të vitit 2012. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për t'i dorëzuar të dhënat shtesë për këtë periudhë tre mujore për Raportin e Progresit të Kosovës për Komisionin Evropian, i cili do të publikohet në vjeshtën e këtij viti.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport fokusohen në arritjet e bëra karshi:

- zbatimin të reformave;
- zhvillimin e kapaciteteve legislative dhe administrative;
- sfidat e identifikuara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2011, dhe
- Zbatimin e prioriteteve të Partneritetit Evropian, përmes Planit të Veprimit për Partneritet Evropian;

Struktura e të dhënave korrespondon me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2011 duke ofruar informata mbi tri fushat në vijim: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane. Raporti gjithashtu është i bazuar në raporte periodike (tre mujorësh) të hartuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

## **1. KRITERET POLITIKE**

### **1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit**

#### **1.1.1. Institucionet**

Gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka pranuar gjithsej 24 raporte, 19 nga ekzekutivi dhe 5 nga institucionet e pavarura. Ndërsa në drejtim të ngritjes së kapaciteteve janë punësuar dy zyrtar në Divizionin për Standardizim dhe Harmonizim ligjor, si dhe janë mbajtur 7 trajnime dhe janë trajnuar gjithsej 245 zyrtarë.

Për më tepër Qeveria ka miratuar në datën 7 mars 2012 UA nr. 02/64 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre.

Sa i përket plotësimit të kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale në Shkurt 2012 është nxjerr dhe nënshkruar UA 2012/02 për zbatimin e ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si UA 2012/01 për monitorimin e Kuvendeve të Komunave të Kosovës përmes pajisjeve të teknologjisë informative "teleprezencës" Janar 2012.

Doracaku shpjegues për zbatimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndër-komunal është finalizuar në muajin mars 2012 dhe pritet të publikohet dhe t'i dërgohet komunave.

Sa i përket fushës së decentralizimit është hartuar plani për ngritjen e kapaciteteve për komunat e reja. Raporti i përgjithshëm i vlerësimit të kapaciteteve të komunave është hartuar dhe publikuar në muajin mars 2012. Gjithashtu është hartuar raporti vjetor i punës së Grupit Ndërministrorë për Decentralizim.

#### **1.1.2. Parlamenti / Zgjedhjet**

Sa i përket reformës zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 23 mars 2012, ka proceduar në Gjykatën Kushtetuese amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në lidhje me përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Ferizajt; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar kandidatët e partive politike për zgjedhjet që pritet të mbahen më 29 prill 2012.

KQZ me datën 19 mars ka miratuar UA 01/2012 për emërimin/shkarkimin e Kryeshefit ekzekutiv, zëvendës Kryeshefit ekzekutiv, drejtorit të zyrës për regjistrimin e partive politike dhe zëdhënësit për informim publik. Gjithashtu KQZ ka miratuar planin e punës për vitin 2012.

Gjatë kësaj periudhe Sekretariati i KQZ-së ka mbajtur dy trajnime për stafin, ku janë trajnuar katër zyrtarë: dy për "Statistikat me Programe Kompjuterike Softuerike SPSS" dhe dy të tjerë për "Zbatim të Ligjit të punës në praktikë".

#### **1.1.3 Administrata Publike**

Në vazhden e kompletimit të kornizës ligjore për RAP me datën 2 mars është miratuar Rregullorja Nr.05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil.

Për më tepër në takimin e Komisionit Ndërministror për Reformën e Administratës Publike (KNRAP) të mbajtur më datën 9 mars 2012 është miratuar propozim-Plani i Veprimtimit për Zbatimin e Strategjisë së rishikuar të Reformës së Administratës Publike, si dhe është miratuar me vërejtje Plani Zhvillimor Strategjik i MPMS-së.



Më tej, bazuar në planin e trajnimit të nëpunësve civil deri më tani janë organizuar 35 kurse trajnimi në fushat organizative: menaxhim i përgjithshëm, administratë dhe legjislacion, burime njerëzore, ITB prokurim publik, çështje të BE-së dhe çështje komunale, ku gjithsej janë trajnuar 496 nëpunës civil. Kurse në 6 punëtoritë e organizuara nga ReSPA kanë marr pjesë gjithsej 24 nëpunës civil nga 15 institucione.

Në aspektin e monitorimit mbi zbatimin e procedurave Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC) ka shqyrtuar tetëdhjetë e dy (82) kërkesa për autorizimin e shpalljes së rekrutimit të institucioneve të cilat punësojnë nëpunës civil.

#### **1.1.4. Sistemi gjyqësor**

Me datë 1 shkurt është miratuar UA mbi ricaktimin/transferimin e gjyqtarëve në gjykatën e apelit, ndërsa me 24 shkurt është miratuar Rregullorja për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Për më tepër, Komisioni Mbikëqyrës për implementimin e Ligjit të ri të Gjykatave ka përcaktuar numrin e gjyqtarëve të nevojshëm për gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe ka filluar procesin e caktimit të gjyqtarëve në Gjykatë të Apelit. Po ashtu edhe nga ana e KPK-së është miratuar Rregullorja për caktimin e procedurave dhe kritereve për vlerësimin e performancës së prokurorëve e cila ka hyrë në fuqi me 1 janar; si dhe UA për përcaktimin e normës vjetore për prokurorë e cila është miratuar me 24 janar. Ndërsa me 1 dhjetor, respektivisht 5 dhjetor 2011 janë miratuar Plani Transitor për Gjykatat, si dhe Plani Transitor për Prokurorinë. Për më tepër, me 9 mars KGJK ka miratuar Strategjinë për Teknologjinë Informative.

Me 20 mars 2012, KPK ka miratuar rregullorën për caktimin dhe transferimin e prokurorëve. Ndërsa me 3 prill 2012, KPK ka shpall njoftim të brendshëm, ku ka ftuar të gjithë prokurorët e interesuar të sistemit prokurorial për të aplikuar në pozitat për prokurorë në Prokurorinë e Apelit dhe Prokuroritë Themelore duke përfshirë aplikimin në departamentet përkatëse. Me 17 prill 2012, KPK ka marr Vendim për caktimin e numrit të prokurorëve në Prokuroritë themelore dhe atë të apelit.

Me 17 prill 2012, KPK ka shqyrtuar dhe miratuar propozimin e panelit vlerësues të KPK, të 13 kandidateve për Prokurorë në sistemin prokurorial të Kosovës. Me 20 prill 2012, KPK ka dërguar propozimet e 13 kandidateve për prokuror tek Presidentja për dekretim.

Me 22 mars 2012, KPK ka nënshkruar memorandum të bashkëpunimit me Rrjetin ballkanik për gazetari hulumtuese.

Në vazhden e plotësimit të pozitave për gjyqtarë me datë 23 mars Presidentja e Kosovës ka dekretuar 11 gjyqtarë, 7 prej të cilëve marrin detyrën për herë të parë. Për më tepër, KGJK gjatë periudhës raportuese ka rekrutuar 12 persona staf mbështetës.

Gjatë periudhës raportuese KGJK ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me Zyrën e Kryeministrit/Gazetën Zyrtare, respektivisht me Ministrinë e Financave/Thesarin, për dërgimin e gazetës zyrtare dhe obligimet e KGJK-së për pagesë, respektivisht lidhur me delegimin e menaxhimit të shpenzimeve.

Sa i përket masave disiplinore për gjykatës dhe prokurorë, gjatë periudhës raportuese janë shqyrtuar 20 raporte përfundimtare për procedura disiplinore për gjithsej 12 gjyqtar, të cilat, ndër të tjera, kanë rezultuar me suspendimin e dy gjyqtarëve deri në përfundim të procedurës disiplinore. Në anën tjetër, nga 19 rastet e paraqitura ndaj prokurorëve që nga themelimi i KPK-së, deri më tani, Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe vendosur për gjithsej 12 lëndë, prej tyre 7 janë lëndë të pezulluara, 1 hedhje e raportit, 1 qortim, 1 suspendim, dhe 2 raste me vendim për zvogëlim të pagës deri në 50%; ndërsa 7 lëndë ende

janë në proces. Ndërlidhur me procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve si dhe planifikimit më efikas të zvogëlimit të rasteve të grumbulluara, KPK me 20 mars ka marr vendim për regjistrimin e lëndëve të grumbulluara në aplikacionin e Bazës së Shënimeve.

Gjatë periudhës raportuese 79 pjesëmarrës kanë vijuar trajnime në temat "Krimi i Organizuar", "Zbatimi i Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit dhe Dëshmitarit të Mbrojtur" si dhe "Dëshmitarët në Procedurën Penale", nga ta 22 gjyqtarë, 1 prokurorë, si dhe 56 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe janë certifikuar 10 trajnues, 2 në fushën e krimit kibernetik dhe 8 për Konventën për të Drejtat e Njeriut.

### **1.1.5. Politikat Kundër Korrupsionit**

Sa i përket politikave kundër korrupsionit AKK me datë 28 mars ka paraqitur para Kuvendit raportin vjetor të punës për vitin 2011. Procesi i rregullt i deklarimit të pasurisë në AKK ka përfunduar me 31 mars. Nga 3657 zyrtarë të lartë publik të obliguar për deklarim të pasurisë, 3354 prej tyre kanë deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor, 6 zyrtarë kanë njoftuar AKK-në për arsyet e pamundësisë së deklarimit të pasurisë, 36 zyrtarë të lartë publik kanë deklaruar pasurinë pas afatit (deri 11.04.2012), ndërsa 261 zyrtarë të lartë publik nuk kanë deklaruar fare pasurinë dhe emrat e tyre janë bërë publik nga AKK, sipas ligjit. AKK është në fazën e regjistrimit të informatave në bazën e të dhënave dhe inicimin e procedurave kundërvajtëse në gjykatat kompetente. Gjatë kësaj periudhe AKK ka zhvilluar trajnim 4 ditorë për 74 zyrtarët kontaktues të institucioneve të linjës lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë.

## **1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

### **1.2.1 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

Në fushën e të drejtave të njeriut, sa i përket personave të zhdukur, me datë 9 mars është mbajtur takimi i Grupit Punues për Persona të Zhdukur në mes të Delegacionit të Prishtinës dhe Delegacionit të Beogradit si dhe seanca informuese me familjet e personave të zhdukur.

Sa i përket të drejtave pronësore, lidhur me zbatimin e marrëveshjes për kthimin e dosjeve kadastrale, në takimin e mbajtur më datë 4 prill është dorëzuar lista përfundimtare e të gjithë dokumentacionit të regjistrit kadastral nga ana e Serbisë.

Për më tepër, në fushën e lirisë së shprehjes, më datë 26 mars Kuvendi ka miratuar Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media si dhe Ligjin për Transmetuesin Publik/RTK. Për më tepër është caktuar buxheti për transmetim në gjuhët zyrtare në përputhje me ligjin e ri për RTK-në. Ndërsa është përgatitur raport rreth zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Sa i përket barazisë gjinore, janë organizuar dy tryeza diskutimi: "Roli i Medieve në Trajtimin e Çështjeve Gjinore" dhe "Fuqizimi i gruas në vendet rurale-sfidat dhe mbështetja institucionale".

### **1.2.2. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve**

Sa i përket reformimit të komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mbi përdorimin e gjuhëve, me datë 21 mars Qeveria ka aprovuar Rregulloren për zyrën e komisionarit të gjuhëve.

Sa i përket integritetit të komuniteteve RAE dhe mbylljen e kampeve të kontaminuar me plumb, janë zhvendosur 3 familje nga kampi Osterode, njëra në Roma Mahallë, dy të tjera te Tre Soliterat në pjesën veriore të Mitrovicës. Me këtë zhvillim numri i familjeve të cilat aktualisht janë ende të vendosur në kamp zbrit në 14 familje. Për më tepër është përpiluar manuali për trajnim të punëtorëve shëndetësor, social, psikolog, pedagog dhe anëtarëve të komunitetit që do të ofrojnë trajnime apo aktivitete brenda komuniteteve lidhur me helmimin nga plumbi dhe avokimin për çështje shëndetësore. Raporti vlerësues mbi

shkallën e kontaminimit si i tillë është përpiluar mirëpo për shkak të specifikës së kontaminimit ky raport përditësohet sipas vlerave të gjetura në terren.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar gjithsej 13 persona, 11 të rritur dhe 2 fëmijë ku 3 prej tyre janë në ri-trajtim si pasojë e efektit rebound. Numri i matjeve të nivelit të plumbit në këtë periudhë ka qenë 467 matje ku prej tyre 154 kapilare dhe 313 venoze.

Në fushën e kthimit, janë themeluar tri ZKKK të reja (Klokot, Partesh dhe Ranillug). Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, gjatë muajit mars janë zhvilluar trajnimet regjionale për të gjitha zyrat për komunitete dhe kthim, me temën riatdhësimi i personave dhe ri-integrimi në shoqëri.

MKK në projektin e përbashkët me Ambasadën Britanike ka filluar ndërtimin e 8 shtëpive për familjet e zhvendosura të komunitetit RAE, në komunën e Istogut.

Gjatë kësaj periudhe është bërë shpërndarja e 530 m<sup>3</sup> të lëndëve djegëse për familjet e kthyer dhe familjeve me kushte të vështira sociale, si dhe 20 pakove ushqimore-higjienike. Gjithashtu është bërë shpërndarja e 25 pakove ushqimore-higjienike për komunitetin Goran, në fshatin Restelicë KK Dragash. Janë përkrahë 15 projekte të OJQ-ve në shumën prej 64,677.00 euro, të cilat kanë pasur për bazë stabilizimin, ri-integrimin e komuniteteve dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë ekonomike të komuniteteve pakicë, si dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset e vendimmarrjes dhe të integritit të tyre të suksesshëm.

### **1.3. Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare**

Në bazë të marrëveshjes së arritur në Bruksel mbi pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale, Kosova për herë të parë ka marr pjesë në Mbledhjen e Bordit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) që është mbajtur me datë 14 dhe 15 mars në Sarajevë, ndërsa me 23 shkurt në Bruksel është mbajtur takimi Strategjik dhe takimi i Komitetit Drejtues i CEFTAs. Nga data 29 shkurt deri 1 mars në Tiranë është mbajtur takimi i Task Forcës për Portalin e CEFTAs. Po ashtu me 30 mars në Tiranë është mbajtur takimi i katërt i Grupit Punues për Tregtinë në Shërbime. Sa i përket bashkëpunimit ndër-kufitar me 6 mars është bërë operativ Sekretariati i Përbashkët Teknik me Shqipërinë dhe është themeluar Komiteti i Përbashkët i Monitorimit me Maqedoninë.

## **2. KRITERET EKONOMIKE**

### **2.1. Funksionimi i Ekonomisë së Tregut**

Gjatë kësaj periudhe (shkurt- mars) Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka bërë vlerësimin e dytë të programit SMP (Staff Monitored Program) për periudhën shtator-dhjetor 2011. Të gjitha kriteret kuantitative të përcaktuara për fund të dhjetorit 2011 janë përmbushur me përjashtim të akumulimit të borxheve të papaguara të Qeverisë ndaj furnitorëve, të cilat janë akumuluar në vlerë të ulët. Në përputhje me këto zhvillime FMN ka lëshuar vlerësim pozitiv mbi performancën makroekonomike të Kosovës gjatë periudhës qershor-dhjetor duke e vlerësuar si të suksesshëm implementimin e programit SMP. Kjo ka mundësuar negociimin e marrëveshjes së re Stand By Arrangement me këtë institucion. Qeveria e Kosovës, ka arritur pajtueshmëri mbi programin e ri Stand-By për periudhën e ardhshme 20 mujore në vlerë prej €107 milion, nga të cilat pjesa më e madhe në vlerë prej €92 milion pritet të disbursohet gjatë vitit 2012.

Në harmoni me vlerësimin pozitiv të performancës makroekonomike nga ana e FMN-së, gjatë muajit mars 2012, Qeveria e Kosovës ka përmbyllur negociatat me Bankën Botërore (BB) për disbursimin e kështit të dytë të ndihmës direkte buxhetore në vlerë prej €36 milion si pjesë e Programit për Punësim të Qëndrueshëm. Disbursimi i këtyre mjeteve pritet të ndodhë gjatë gjysmës së parë të vitit 2012.

#### **2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike**

Në mungesë të të dhënave aktuale për vitin 2011, vlerësimet për rritjen ekonomike janë të bazuar në trendet aktuale të indikatorëve kyç makroekonomik. Bazuar në këta indikatorë, rritja reale e BPV-së për vitin 2011 vlerësohet të ketë shënuar një normë vjetore prej 5.3%. Shtytësi kryesor i rritjes ekonomike për vitin 2011 vlerësohet të jetë konsumi privat me një kontribut në rritje ekonomike prej 3.0% dhe konsumi publik me 0.7%. Si kontribuues sekondar në rritjen e BPV-së për vitin 2011 ishin investimet e përgjithshme, nga të cilat investimet publike kontribuuan me 1.1% dhe ato private me 1.0%. Përkundër rritjes së konsiderueshme të eksportit, eksporti neto mbetet përsëri kontribuues negativ në rritjen reale i cili vlerësohet të ketë kontribuar negativisht me 1.7% në rritjen reale të BPV-së gjatë vitit 2011. Kontribut negativ në rritjen reale të ekonomisë vlerësohet të ketë dhënë edhe reduktimi i prezencës së donatorëve në Kosovë.

Konsumi i përgjithshëm përgjatë vitit 2011 vlerësohet të ketë pasur rritje vjetore prej 9.9%, nga i cili konsumi private u rrit me një ritëm më të shpejtë (10.0%) në krahasim me konsumin publik (9.6%). Kjo ngritje në konsumin privat, përpos tjerash, i atribuohet rritjes së të ardhurave të disponueshme si rezultat i ngritjes së pagave për punonjësit në sektorin publik si dhe rritjes natyrale të popullsisë dhe gjithashtu zgjerimit të aktivitetit ekonomik në vend. Bazuar në të dhënat e importit dhe të kreditimit nga ana e sektorit financiar, investimet private janë vlerësuar të jenë rritur me 10.8% gjatë vitit 2011, ku investimet publike u rritën me një ritëm më të shpejtë (16%) si rezultat i investimeve kapitale me theks te veçantë investimet në rrugën 7 (Merdare-Morinë). Për më shumë, rritja nominale e komponentëve të BPV-së gjatë vitit 2011 mund t'i atribuohet edhe ngritjes së nivelit të çmimeve edhe pse të dhënat mbi sasinë e mallrave të importuara e që kryesisht përdoren për konsum dhe investime tregojnë për një rritje të konsiderueshme të këtyre komponentëve edhe në vlerë reale.

Për sa i përket sektorit të jashtëm gjatë vitit 2011 eksporti i mallrave shënoj një rritje prej 2.5% përderisa importi i mallrave u rrit me 14%. Këto zhvillime tregojnë që edhe përkundër faktit që eksportet në vitet e fundit kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, për shkak të bazës së ulët si dhe për shkak të projekteve të mëdha investive të cilat stimulojnë në masë të madhe importin, nuk mund të pritet të ketë ndonjë përmirësim të konsiderueshëm në bilancin tregtar.

## **Zhvillimet në Bilancin e Pagesave**

Vlerësimet për bilancin e pagesave për vitin 2011 tregojnë për një ngritje të deficitit tregtar, përmirësim të llogarisë së shërbimeve, përmirësim të lehtë të llogarisë së të ardhurave dhe atë të transfereve dhe si rrjedhojë ngritje të llogarisë rrjedhëse.

Gjate vitit 2011, importi i mallrave vlerësohet të jetë rritur me 14% kryesisht si rrjedhojë e rritjes së konsumit dhe investimeve, të shoqëruara me një ngritje rapide të çmimeve ndërkombëtare të mallrave të importuara. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të metaleve, kryesisht gjatë kuartalit të katërt, ka ndikuar në rënien e vlerës së eksportit të mallrave i cili gjatë vitit 2011 vlerësohet të jetë rritur me 6.5%. Si rezultat, bilanci tregtar ka shënuar rritje në raport me BPV-në për 2.9 pika të përqindjes.

Në anën tjetër, eksporti i shërbimeve ka shënuar një ngritje të theksuar prej 19.6% gjatë vitit 2011 krahasuar me rënien e importit të shërbimeve prej 8.6%. Kjo ngritje e eksportit të shërbimeve kryesisht është ndikuar nga ngritja e shërbimeve të udhëtimit si dhe atyre të komunikimit dhe ndërtimitarisë. Me saktësisht, neto shërbimet e udhëtimit gjatë këtij viti u ngritën me 40.2% përderisa shërbimet e komunikimit u ngritën me 57.1%. Si rezultat, neto shërbimet në raport me BPV-në u ngritën për 2.7 pika të përqindjes duke kompensuar kështu përkeqësimin e bilancit tregtar.

Për sa i përket llogarisë së të hyrave, gjatë vitit 2011, të hyrat nga kompensimi i punëtorëve janë ngritur me një normë prej rreth 25% krahas rritjes më të ngadalshme të të dalave në formë të profitit të rikthyer nga investimet e huaja direkte si dhe investimeve tjera nga ana e investitorëve të huaj. Si rezultat, llogaria e të hyrave neto ka shënuar një ngritje prej rreth 19% apo 0.5 pika të përqindjes në raport me BPV-në. Në vitet në vijim, ngritja e të hyrave neto pritet të ngadalësohet për faktin që investimet e institucioneve financiare vendore do t'i orientojnë investimet e tyre në bonot e thesarit të cilat Qeveria ka filluar t'i lëshoj në fillim të vitit 2012.

Llogaria e transfereve vlerësohet të ketë mbetur konstante edhe përkundër ngritjes së dërgesave nga diaspora. Kjo për faktin që transferet zyrtare janë duke u zvogëluar në vazhdimësi si rrjedhojë e zvogëlimit të vazhdueshëm të prezencës së misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Për më shumë, gjatë vitit 2011, neto dërgesat nga diaspora janë ngritur me 0.9% krahasuar me vitin 2010 kryesisht si pasojë e ngritjes më të shpejtë të dërgesave që ndërkombëtarët i dërgojnë në vendet e tyre. Në anën tjetër, transferet tjera private po ashtu janë ngritur me 20.4% duke ngritur kështu vlerën e neto transfereve totale për 4.4% krahasuar me vitin 2010.

Për sa i përket llogarisë kapitale dhe financiare, kontributin më të madh në ngritjen e tyre e kanë dhënë ngritja e konsiderueshme e investimeve direkte për 5.9% si dhe rënia e theksuar e investimeve portfolio për 37.8% gjë që ndërlidhet me zhvillimet e fundit në vendet anëtare të euro-zonës. Për më shumë, këto investime pritet të bien edhe më tepër duke u bazuar në faktin që institucionet financiare do t'i orientojnë investimet e tyre drejt bonove të thesarit të lëshuara nga Qeveria e Kosovës (shih tabelën 2 në aneks për detaje).

## **Trendet në punësim**

Bazuar në të dhënat e regjistruara mbi numrin e të papunëve nga MPMS, numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të shkurtit 2012 ishte 276,655 duke shënuar një rënie prej 17.7% krahasuar me numrin e të regjistruarve në periudhën e njëjtë të vitit 2011. Kjo rënie në numrin e të papunëve të regjistruar kryesisht i atribuohet digjitalizimit të regjistrimit të numrit të të papunëve në MPMS, i cili sistem tash e tutje pritet të ofrojë informata më të besueshme mbi numrin e të papunëve të regjistruar.

Nga ana tjetër, numri i të punësuarve përmes zyrave të punësimit deri në fund të vitit 2011 arriti në 6,517 persona. Gjatë muajit shkurt 2012 janë regjistruar 1,709 persona të ri si të papunë ndërkaq që janë punësuar 307 persona.

### **2.1.2. Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese** **Evoluimi i kornizës së politikave monetare**

**Korniza e normës së këmbimeve:** shih tabelën 3 në aneks për ecuritë e normës efektive reale dhe nominale të këmbimit.

#### **Evoluimi i politikave fiskale**

Me buxhetin e vitit 2012 janë përcaktuar shpenzime në nivelin prej €1,548 milion, ndërsa të hyrat e projektuara kapin shumën prej €1,395.5 milion. Nën supozimin e realizimit të plotë të të hyrave dhe shpenzimeve të projektuara, pritet që deficitin primar për vitin 2012 të jetë €159 milion, ndërsa deficitin i përgjithshëm (që përfshin pagesën e interesit dhe kredi-dhënien për ndërmarrjet publike) do rezultojë në €172 milion.

Për vitin 2012, është projektuar se €287.8 milion euro do të arkëtohen nga Administrata Tatimore e Kosovës. Deri në fund të periudhës raportuese (shkurt 2012), ATK ka arritur të arkëtojë €49.4 milion, apo 17% të vlerës së projektuar vjetore. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011 kur të hyrat e grumbulluara ishin në vlerë prej €46 milion, vërehet një ngritje prej 7%.

Të hyrat në kufi janë projektuar të arkëtohen në nivelin prej €867.3 milion me buxhetin e vitit 2012. Autoritet doganore kanë arritur që deri në fund të shkurtit 2012 të arkëtojnë €85.74 milion, apo 10% të vlerës së projektuar vjetore.

Ndërkaq të hyrat jo tatimore dhe të hyrat vetanake (komunale dhe qendrore) për vitin 2012 janë projektuar në vlerë prej €171.5 milion. Nga këto, të hyrat jo-tatimore janë parashikuar të jenë €48.09 milion nga të cilat deri në fund të shkurtit janë arkëtuar €5.72 milion apo 12% e planit realizues. Ndërsa të hyrat vetanake (komunale dhe qendrore) janë parashikuar në vlerë prej €123.4 milion, nga të cilat deri në fund të shkurtit janë arkëtuar €16.97 milion apo rreth 14% e planit vjetor.

Gjatë periudhës janar - shkurt 2012 janë shpenzuar €178.3 milion, apo rreth 12% të vlerës së buxhetuar. Në nivelin qendror, shpenzimet kapitale ishin €74.18 milion euro me një normë të realizimit prej 15% gjatë periudhës janar - shkurt të 2012-ës, ndërsa në nivelin komunal këto shpenzime arritën vlerën €8.39 milion euro me normë të realizimit në nivelin prej 7%. Në total, gjatë periudhës së raportuar janë shpenzuar €82.57 milion euro në shpenzime kapitale, ndërsa janë shpenzuar €94.6 milion në shpenzime rrjedhëse (nga të dyja nivelet e qeverisjes). Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, i janë disbursuar €1.05 milion KEK-ut në formë kredie. Duke marrë për bazë nivelin e të hyrave dhe shpenzimeve, deri në fund të shkurtit 2012, buxheti i Republikës së Kosovës është përcjellur më një deficit në vlerë prej €2.99 milion, për më shumë tabela 4 në aneks paraqet shpenzimet sipas nën-kategorive për qeverinë qendrore dhe qeverinë lokale.

**Borxhi i përgjithshëm i qeverisë:** Qeveria e Kosovës nisi vitin fiskal 2012 me një borxh të përgjithshëm prej €253.6 milion. Pjesa më e madhe e kësaj vlere ose €226.3 milion ishte borxh nga Kredia e Konsoliduar C (KKC) e trashëguar nga ish-Jugosllavia, kurse pjesa e mbetur duhet t'i kthehet kreditorëve si në vijim: rreth €22.2 milion (18.8 milion SDR) është borxh ndaj FMN-së dhe rreth €5.1 milion (4.3 milion SDR) Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtarë (AZHN).

Gjatë tre muajve të parë të këtij viti janë bërë pagesa për shërbimin e borxhit ndaj FMN-së, në emër të interesit janë paguar €64,296, po ashtu është bërë pagesa për shërbimin e borxhit të trashëguar (kredisë KKC) në shumën €9,940,373, përkatësisht kryegjësë €5,668,538 dhe interesit €4,271,835. Si rezultat i këtyre pagesave, borxhi i jashtëm i Qeverisë së Kosovës në fund të muajit mars ishte €248 milion.

Një ndër aktivitetet tjera më të rëndësishme për borxhin publik ishte hapja e tregut të letrave me vlerë në janar të këtij viti. Gjatë tremujorit të parë me sukses janë organizuar tri ankande dhe si rezultat janë emetuar bono thesari me vlerë nominale 30 milion euro dhe me maturitet 91 ditë (në secilin ankand nga €10 milion). Stoku total i borxhit të përgjithshëm në fund të muajit mars ishte €278 milion ose 5.76% e BPV-së.

### **2.1.3. Funksionimi i tregjeve të produkteve**

#### **Liberalizimi i çmimeve**

##### **Madhësia e sektorit privat**

Të dhënat e fundit të disponueshme tregojnë që konsumi privat nuk ka shënuar lëvizje të theksuara duke mbetur kështu në një mesatare prej 91.3% të BPV-së. Ndërsa, investimet private janë vlerësuar të jenë rritur nga 21.8% në 2010 në 22% në 2011, si përqindje e BPV-së e kjo si rezultat i rritjes më të shpejtë të komponentëve tjera të BPV-së, siç është rritja me e përshpejtuar e investimeve kapitale gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010. Megjithatë vlen të ceket se investimet private në vlerë nominale gjatë vitit 2011 kanë shënuar ngritje krahasuar me vitin 2010, për më shumë shih tabelën 5 në aneks.

##### **Privatizimi**

Gjatë periudhës raportuese, nga shpërndarja e parakohshme e 20% të të ardhurave të disponueshme nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore kanë përfituar 92 punëtorë ku shuma e shpërndarë është €54,310.12 . Po ashtu është kompletuar dokumentacioni për shpërndarje edhe për 17 NSh për të cilat Oda e Veçantë ka konfirmuar se nuk ka ankesa dhe nuk është kundërshtuar, kurse shuma që do të shpërndahet është €305,157.20. Nga janari 2012 janë publikuar 19 lista finale dhe 8 lista fillestare të përfituesve të 20%.

##### **Hyrja dhe dalja e bizneseve**

Gjatë periudhës raportuese janar - mars 2012 në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) janë regjistruar gjithsej 2,543 biznese, kurse në të njëjtën periudhë janë shuar 220 sosh.

##### **Ambienti biznesor, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative**

Në kuadër të lehtësive për të bërë biznes janë eliminuar leja e punës, leja sanitare, është reduktuar numri i dokumenteve për eksport-import si dhe është eliminuar nevoja për regjistrimin e kompanive tek Doganat e Kosovës për import/eksport, rrjedhimisht edhe eliminimi i taksës për këtë shërbim. Tani kompanitë përmes certifikatës së TVSH-së do t'i kryejnë edhe aktivitetet për eksport/import. Është eliminuar taksa e regjistrimit, pra, regjistrimi behet falas. Gjithashtu, është shkurtuar afati i regjistrimit të biznesit (tani regjistrimi bëhet brenda ditës) si dhe janë reduktuar procedurat e regjistrimit. Siç janë:

- Regjistrimi i biznesit behet brenda ditës. Tani, regjistrimi i biznesit behet pa pagese;
- Leja e punës nga komuna është eliminuar tërësisht;
- Është eliminuar nevoja për regjistrimin e kompanive pranë Doganave të Kosovës për import dhe export. Tani kompanitë përmes certifikatës së TVSH-se do t'i kryejnë aktivitetet për export/import;
- Është reduktuar numri i dokumenteve për import nga 8 në 4 dhe për export nga 7 në 3 dokumente;
- Marrja e certifikates së TVSH-se nga 10 është shkurtuar në vetëm 1 ditë;

- Kërkesa për kapital themeltar është eliminuar ose reduktuar. Regjistrimi për SH.P.K. për kapital themeltar është eliminuar plotësisht. Ndërsa për Shoqëritë Aksionare kapitali themeltar nga 25,000 Euro është ulur në 10,000 Euro.

Në kuadër të masave për përforsimin e të drejtave pronësore, gjatë periudhës raportuese janë implementuar 2,100 kërkesa pronësore (në të gjitha format e implementimit si: të riposedimit, administrimit, mbylljes së lëndës me kërkesë të palës etj). Komisioni për kërkesa pronësore ka mbajtur një sesion ku janë vendosur 3442 kërkesa të paraqitura.

Ndërsa nga aspekti i masave administrative dhe gjyqësore janë emëruar 46 noterë nëpër komunitet e ndryshme të Kosovës (30.03.2012).

#### **2.1.4. Sektori financiar**

Vlera totale të asetëve të sektorit financiar në 2011 arriti në €3.5 miliard (75.1% e BPV). Sistemi bankar vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe të sektorit financiar (76.1% të asetëve financiare, pa asetet e BQK-së).

Fondet pensionale menaxhuan me 17% të asetëve, ndërsa pjesa tjetër e asetëve u menaxhuan nga institucionet mikrofinanciare (3.7% e asetëve), kompanitë e sigurimit (3.2% e asetëve) dhe ndihmësit financiarë (0.02% e asetëve). Lidhur me numrin e institucioneve financiare në Kosovë, viti 2011 nuk u karakterizua me ndonjë ndryshim substancial. Numri i bankave komerciale, fondeve pensionale dhe institucioneve mikrofinanciare mbeti i njëjtë si në vitin paraprak (8 banka, 2 fonde pensionale dhe 59 institucione mikrofinanciare dhe ndihmës financiar) por dy kompani shtesë të sigurimeve që ofrojnë polisa sigurimi të jetës kanë hyrë në këtë industri.

Struktura e pronësisë së sektorit bankar në Kosovë nuk ka ndryshuar që nga viti 2008, duke u përbërë nga 6 banka në pronësi të huaj dhe dy me pronësi vendore. Sistemi bankar mbetet i dominuar nga bankat e huaja, të cilat menaxhojnë rreth 89.6% të asetëve bankare. Për më tepër, sektori bankar karakterizohet me një shkallë relativisht të lartë të koncentrimit. Kjo ngase tri bankat më të mëdha në vend menaxhojnë rreth 70% të asetëve bankare. Sidoqoftë, në vitet e fundit, shkalla e koncentrimit ka rënë në vazhdimësi. Shkalla e koncentrimit e shprehur përmes Indeksit të Herfindahl-Hirschman (HHI) për asete ka rënë në 2,090 pikë, krahasuar me 2,299 pikë në 2010.

Kreditimi i ekonomisë mbetet aktiviteti kryesor i sistemit bankar. Kreditë e sistemit bankar dominojnë strukturën e strukturës së asetëve bankare dhe në vitin 2011 kishin pjesëmarrje prej 68.3% të asetëve totale në vitin 2011. Vlera e përgjithshme e kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës në vitin 2011 ishte €1.69 miliardë (rreth 36.5% e BPV). Në tre vitet e fundit kreditë u rritën me trend pozitiv: 8.9% në 2009, 13.3% në 2010 dhe 16.4% në 2011. Për më tepër, në pjesën e parë të vitit 2011 bankat kanë raportuar rritje të kërkesës për kredi veçanërisht nga ndërmarrjet e vogla e të mesme. Indikator shtesë i kësaj rritje mund të jetë norma e përshpejtuar e rritjes së kredive për ndërmarrjet prej 12.5% në 2011 krahasuar me rritjen prej 7.9% në 2010. Kreditë për ekonomitë familjare vazhduan të rriten me një ritëm më të ngadalësuar prej 17.7% krahasuar me 24% në 2010.

Struktura e kredive në 2011 u dominua nga kreditë e dhëna ndërmarrjeve, që përbënin rreth 69.9% të gjithë kredive, ndërsa pjesa tjetër prej 30.1% ishin kredi për ekonomitë familjare. Niveli i ulët i prodhimit në ekonominë e Kosovës dhe mbështetja e lartë në importet nga jashtë është reflektuar edhe në shpërndarjen sektoriale të kredive për ndërmarrjet private. Pjesa më e madhe e kredive ishte absorbuar nga sektori i shërbimeve (52.7%), pasuar nga kreditë e industrisë (24.8%), bujqësisë (3.5%), etj.



Profiti neto i sektorit bankar për vitin 2011 ishte €37 milionë (€32.8 milion në 2010). Faktorët kontribuues në përmirësimin e performancës së sektorit bankar në 2011 ishin rritja e të gjitha kategorive të të hyrave, veçanërisht të hyrat nga interesi (të hyrat nga interesi përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave bankare). Rritja e profitit neto rezultoi edhe në përmirësimin e indikatorëve të performancës si Kthimi Mesatar në Asete (Return on Average Assets-ROAA) dhe Kthimi Mesatar në Kapital (Return on Average Equity-ROAE). Në vitin 2011, ROAA ishte 1.5% dhe nuk ndryshoi nga viti i kaluar, ndërsa ROAE u rrit nga 14.8% në 2010 në 15.3% në 2011.

Sidoqoftë, të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe në vazhdimësi e mbajnë Treguesin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) mbi kriterin minimal prej 12% të përcaktuar nga BQK. Në dhjetor të 2011, TMK qëndroi në 17.6% (17.9% në janar 2012).

Viti 2011 u karakterizua me një rënie të lehtë të normave të interesit si për kreditë ashtu edhe për depozitat. Norma mesatare e interesit për kreditë në 2011 ishte 14.6% që është konsistente me normën e vitit paraprak. Norma mesatare për depozita gjatë 2011 ishte 3.5% krahasuar me normën mesatare për depozita prej 4% në 2010.

Portfolio investimet jashtë vendit në 2011 shënuan rënie duke arritur në €143.6 milion deri në dhjetor 2011 (€231.0 milion deri në dhjetor 2010). Zhvillimet në tregjet financiare globale mund të konsiderohen si një nga kontribuuesit në rënien e portfolio investimeve. Nga gjithsej €143.6 milionë (3.1% e BPV) të portfolio investimeve, 67.2% janë investime në tregje të kapitalit në vendet tjera, derisa 32.8% janë investime në bono dhe obligacione. Fondet pensionale dhe bankat komerciale vendore paraqesin investitorët kryesor në këtë kategori.

## **2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVE TË TREGUT BRENDA UNIONIT**

### **2.2.1. Kapitali Njerëzor dhe Fizik**

**Kapitali njerëzor:** Përmes sistemit informativ për Menaxhimin e Punësimit dhe punëkërkesve të instaluar në të gjitha shërbimet publike të punësimit deri tani janë regjistruar 264,984 punëkërkes. Prej tyre 200,956 janë punëkërkes aktiv dhe 64,028 janë pasiv, ndërsa 60,000 të regjistruar në kartelet e vjetra nuk mund të regjistrohen në sistem të ri pa numër personal të letërnjoftimit.

Në funksion të zbutjes së papunësisë strukturale në Kosovë, Divizioni i Punës dhe Punësimit gjatë periudhës janar-shkurt 2012 përmes shërbimeve publike të punësimit ka ndërmjetësuar në punësim rreth 41 punëkërkes të të gjitha minoriteteve përfshirë edhe romë, ashkali dhe egjiptas (RAE). Në periudhën e njëjtë kohore, shërbimet publike të punësimit kanë regjistruar 4,273 punëkërkes të rinj prej tyre 1,964 femra, 643 nga minoritetet dhe 14 me aftësi të kufizuara dhe kanë ndërmjetësuar në punësim 591 punëkërkes (268 prej tyre femra).

Në Qendrat e Aftësimit Profesional janë zhvilluar paketa programore në 8 profesione të cilat zhvillohen në QAP (elektroinstalues, latues, saldues, uritem, hidroinstalime, përpunim i pemëve dhe fasade).

### **Kapitali fizik**

Sa i përket **infrastrukturës rrugore**, kane vazhduar punimet ne autostradën Morinë-Merdare ku janë përfunduar punët tokësore në segmentin 4b Sllapuzhan-Duhël në gjatësi 4 km dhe është në përfundim Ura Nr. 12 (80%). Në segmentin 5 Duhël-udhëkryqi M9 (Gjurgjicë) është bërë hapja e trasës në gjatësi prej 15 km, është punuar mbikalimi (100%) dhe jane kryer 60% e objekteve në trasë.

Në **sektorin e energjisë**, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së kapaciteteve transmetuese dhe transformuese në rrjetin e transmisionit në periudhën raportuese KOSTT gjatë kësaj periudhe ka implementuar keto projekte:

- Janë zëvendësuar pajisjet e tensionit të lartë të NS 220/110 kV Prizreni 2 dhe është instaluar transformatori i tretë (TR3) 150MVA;
- Janë ndërruar mbrojtjet rele të NS Prishtina 2 dhe NS Prishtina 3.

### **2.2.2. Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit**

Në fushën e **aviacionit civil** nuk ka zhvillime për t'u raportuar.

**Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM)** gjatë periudhës raportuese ka nxjerrë UA për taksën e licencimit dhe urdhëresa tarifore për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave të cilat janë aprovuar me 6.01.2012 dhe . Ndërsa lidhur me përmirësimin e efikasitetit të arkëtimit dhe inkasimit, është përgatitur raporti për gjendjen aktuale të performancës së kompanive rajonale.

Sa i përket **rregullativës së telekomunikacionit**, Bordi i ART-së me 22 shkurt 2012, bazuar në shqyrtimin e materialeve dhe Raportit për analizat e tregut të Telefonisë Fikse, ka miratuar vendimet për definim dhe ato për operatorët e përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg:

- Raportin e Analizës së Tregut të Telefonisë Fikse;
- Aktvendimet për tregjet e definuara (gjithsej 7 vendime);
- Aktvendimet për caktimin e ndërmarrjeve (operatoreve) me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT) sipas tregjeve përkatëse (gjithsej 8 vendime).

Të hyrat nga shërbimet telekomunikuese për tremujorin e katërt 2011 kanë arritur në €55,003,353, e që është rënie prej rreth 13.68% në krahasim me tremujorin paraprak, përkatësisht rënie prej 5% në krahasim me tremujorin e katërt të 2010. Të hyrat e operatorëve mobil përbëjnë rreth 81.7% të të ardhurave të gjithë tregut, ndërsa operatorët fiks zotërojnë rreth 8.6%.

Lidhur me telefoninë fikse, gjatë tremujorit të katërt të 2011, numri i përdoruesve të telefonisë fikse ka shënuar një rritje simbolike prej 0.24%, ku numri i përdoruesve aktiv vlerësohet të jetë rreth 86,000. Pjesa prej 81,700 i takon operatorit PTK sh.a/Telekomit të Kosovës (TiK), ndërsa pjesa tjetër prej 4,804 për operatorin alternativ IPKO.

Lidhur me telefoninë mobile, numri i përdoruesve në fund të tremujorit të katërt 2011 ka arritur në shifrën prej 1,478,944 përdorues, që paraqet një rënie prej 41,498 përdoruesish ose 2.73% më pak në krahasim me tremujorin paraprak, përkatësisht është rritur për 1.87% në krahasim me tremujorin e periudhës së njëjtë të vitit paraprak

Ndërsa sa i përket shërbimeve të internetit, në tremujorin e katërt 2011 është shënuar një rritje në numrin e përdoruesve që kanë qasje në shërbimet e internetit në 143,243 linja aktive e cila paraqet një rritje prej 4.66% në krahasim me tremujorin e tretë 2011, përkatësisht është shënuar një rritje e konsiderueshme prej 13.31% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

### **2.2.3. Zhvendosjet strukturore në ekonomi**

#### **Struktura sektoriale**

Nuk është raportuar asgjë.

### **Struktura sektoriale e shpërndarjes së NVM-ve**

NVM-të e përbëjnë mbi 99% të numrit total të ndërmarrjeve. Ato marrim pjesë me rreth 80% në punësimin e përgjithshëm të sektorit privat.

Struktura e NVM-ve sipas madhësisë përbëhet nga mikro ndërmarrjet me 98.39%, ndërmarrjet e vogla me 1.36%, ndërmarrjet e mesme me 0.20%, dhe ndërmarrjet e mëdha me 0.05%. Nga aspekti i të punësuarve në sektorin privat, mikro ndërmarrjet punësojnë 64.2%, ndërmarrjet e vogla 8.6%, dhe ndërmarrjet e mesme punësojnë 7.9% të të punësuarve.

Për nga forma e pronësisë, NVM-të që kanë formën e regjistrimit si biznes Individual përbëjnë mbi 89.25%, ortakëritë 3.31%, shoqëritë 6.85%, kompanitë e huaja 0.49%, NSH-të 0.02%, ndërmarrjet publike 0.01%, kooperativat 0.06%, dhe ndërmarrjet nen AKP 0.03%.

#### **2.2.4. Intervenimet e Qeverisë në ekonomi**

##### **Ndërmarrjet e mëdha shtetërore**

**Privatizimi i KKDFE:** Afati i fundit për dorëzim të ofertave nga investitorët është data 21 maj 2012, dhe shpallja e fituesit do të bëhet në muajin qershor 2012. Pas përzgjedhjes së fituesit, nënshkrimi i marrëveshjes së shitblerjes do të bëhet brenda 90 ditë pune.

**Privatizimi i PTK-së:** Gjatë këtij tremujori është bërë përzgjedhja e këshilltarit të transaksionit. Po ashtu është themeluar dhe ka nisur punën grupi punues për ndarje të Postës nga PTK dhe është marrë vendimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës për themelimin e bordit të përkohshëm për udhëheqjen e ndërmarrjes së re publike Posta e Kosovës.

##### **Ndihma shtetërore**

Ndihma shtetërore për sektorët publik të energjisë, transportit, dhe sektorin e ujit dhe mbeturinave për vitin 2012 është €30,758,749 ose 0.70% të GDP-së së Kosovës. Për këtë vit janë aprovuar këto mjete: €8,108,749 për investime kapitale dhe €22,650,000 për subvencione. MZHE ka përgatitur marrëveshjen e monitorimit e cila përcakton përgjegjësitë e përfituesit. Ndërmarrjet publike raportojnë në baza tremujore sipas kësaj marrëveshje për progresin e arritur për investimet e përfituara.

#### **2.2.5. Integrimi tregtar**

Shkëmbimi tregtar me vendet e BE-së për muajin janar 2012 arriti vlerën prej €55,793,000, prej të cilave vlera e importeve është €48,296,000 ndërsa vlera e eksporteve është €7,497,000. Nga krahasimi i këtyre të dhënave me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërehet se vlera e importeve është rritur për €4,085,000 ndërsa vlera e eksporteve ka rënë për €5,082,000.

### **3. STANDARDET EVROPIANE**

#### **3.1. Tregu i Brendshëm**

##### **3.1.1 Lëvizja e Lirë e Mallrave**

###### **Standardizim**

AKS për periudhën raportuese ka miratuar gjithsej 82 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC si standarde kosovare. Prej tyre 61 standarde janë nga fusha e teknologjisë agroushqimore dhe 21 standarde nga fusha e energjisë.

###### **Akreditim dhe Vlerësimi i Konformitetit**

Drejtoria e Akreditimit e Kosoves (DAK) është audituar nga menaxherja e cilësisë të DPA-së (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit), auditimi është kryer me 03.02.2012. Nga ana e saj është audituar Sistemi Menagjimit të Cilësisë së DAK sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17011:2004 dhe ate: Manuali i Cilësisë DAK-MC-001, DAK-PM-001, DAK-PM-002, DAK-PM-003, DAK-PM-004, DAK-PM-005, DAK-PO-001, DAK-PO-002, DAK-PO-003, DAK-PO-004, DAK-PO-005, DAK-PO-006, DAK-PO-007, DAK-PO-008, DAK-PT-001, DAK-PT-002, DAK-PT-003, DAK-PT-004, DAK-PT-006. Menaxherja e cilësisë së DPA gjatë kësaj periudhe ka audituar 20 dokumente bazë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DAK.

Gjatë kësaj periudhe është filluar me procedurën DAK-PT-001 për mbikëqyrjen e laboratorëve testues, deri me tani janë mbikëqyrur këta Trupa për Vlerësim të Konformitetit:

- Laboratori për analiza kimike dhe fiziko-mekanike te çimentos, 14.03.2012;
- Laboratori i kontrollit të derivateve të naftës, 05.03.2012;
- Laboratori për analiza të ujit "DEA", 23.01.2012
- Laboratori për analiza të agregateve dhe asfalteve;
- Laboratori për analiza të naftës dhe derivateve te naftës 14.03.2012;
- Laboratori për analiza të vajrave 23.03.2012;
- Laboratori për shqyrtimin e materialit ndërtimor, beton, asfalt si dhe hulumtime gjeomekanike dhe gjeologjike të dherave 22.03.2012;
- Kontrolli i cilësisë së produkteve farmaceutike "Trepfarm Laboratory, 30.03.2012.

Nga DAK deri tani janë akredituar 19 laborator testues dhe një trupë inspektuese, gjithsej kemi 20 Trupa për Vlerësim të Konformitetit të Akredituar. Para-vlerësimi i DAK nga vlerësues të EA për nënshkrimin e MLA-së ka rezultuar me 7 jo-konformitete të zgjidhura, 7 vërejtje të zgjidhura dhe 4 komente të zgjidhura.

Deri me tani kemi akredituar 20 Trupa për Vlerësim të Konformitetit, dhe kemi tri aplikime të reja për akreditim.

###### **Mbrojtja e Konsumatorit**

Është themeluar Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe gjatë kësaj periudhe është punuar në kuadër të vetëdijesimit të konsumatorit ku prej 14.01.2012 është lansuar Spoti në televizionet që operojnë ne Kosovës.

Gjithashtu janë organizuar Ëorkshope si ai ne universitetin UBT me Date 13.03.2012, ne fakultetin Juridik me date 14.03.2012 është organizuar Tryeze me titull roli dhe rëndësia e mbrojtjes se konsumatoreve, po ashtu gjate kësaj periudhe janë zhvilluar Debate televizive, intervista, publikime, fletëpalosje etj.

##### **3.1.2. Lëvizja e Lirë e Kapitalit**

Gjate kësaj periudhe në fushën e zhvillimit të sistemeve ndërbankare bashkëkohore për ofrimin e shërbimeve bankare efektive për klientë, është funksionalizuar divizioni i mbikëqyrjes dhe analizave në kuadër të Departamentit të sistemeve të pagesave dhe është aprovuar Rregullorja për regjistrin e kredive (shkurt 2012). Po ashtu ne janar 2012 janë

finalizuar Electronic Trading Platform Softëare (Platforma elektronike e tregtimit të letrave me vlerë - Softëeri) dhe sistemi depozitar qendror i letrave me vlerë (CSD).

### **3.1.3. Doganat dhe Tatimet**

#### **a. Doganat**

Zëvendësimi i sistemit aktual të IT-TIMS me sistemin ASYCUDA ka shënuar progres. Në janar është përgatitur prototipi i sistemit ASYCUDA Ëorlnd në Doganën e Kosovës, si dhe është definuar procesi i përpunimit të deklaratës doganore në sistemin AË. Janë përcaktuar mënyrat e menaxhimit të ngarkesave exp-imp në pikë kalimet kufitare. Në të njëjtën kohë ka vazhduar ngritja e kapaciteteve njerëzore për përdorimin e sistemit të ri. Nga 27 shkurti e deri në fund të muajit mars 2012 janë trajnuar mbi 200 oficer doganor për punë me sistemin e ri V14.

Ka vazhduar nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok në çështje doganore. Është arritur pajtueshmëria e tekstit të Marrëveshjes me Doganën e Austrisë, si dhe janë shkëmbyer draft marrëveshjet me Kroacinë. Ndërsa janë riaktualizuar negociatat për Memorandumin e Mirëkuptimit me Doganën e Polonisë.

Gjatë periudhës raportuese në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë ndërmarrë 34 raste dhe janë konfiskuar mallra me vlerë 13,495 euro.

Që nga janari 2012 deri më tani janë trajnuar 64 zyrtarë doganor dhe janë organizuar gjithsej 11 trajnime nga fusha e hetimeve kriminale.

Me 2 prill të këtij vitit është funksionalizuar Drejtoria për planifikim strategjik.

Në kuadër të hulumtimit të rasteve me dyshime korruptive janë kryer 5 inspektime si dhe 4 zyrtarë janë raportuar në procedura disiplinore në Sektorin për standarde Profesionale.

#### **b. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)**

Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar ngritja e kapaciteteve njerëzore të ATK-së në lëmin e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe fushave të tjera si aftësitë menaxheriale, tatimet dhe ligjet në vendet evropiane. Gjithsej janë mbajt 36 trajnime me 492 pjesëmarrës. Në fushën e ngritjes së kapaciteteve të stafit, ATK ka marrë asistencë teknike nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare si ESATK, GIZ, OECD dhe IKAP. ATK ka vazhduar me realizimin e projektit të Qendrës së Thirrjeve. Gjatë periudhës janar-mars 2012 Qendra e Thirrjeve ka realizuar 1285 thirrje, thirrje këto të cilat kanë rezultuar me realizimin e të hyrave prej 85 343,62 euro.

Me qëllim të zëvendësimit të sistemit bazë, ATK ka miratuar Strategjinë e Teknologjisë Informative 2012 ku janë përcaktuar objektivat dhe prioritetet. Krahas Strategjisë së Teknologjisë, janë funksionalizuar edhe një sërë modulesh si: moduli i kontrollit, moduli i mbledhjes së detyrueshme, moduli i qendrës së thirrjeve, moduli i ankesave. Projekti i deklarimit elektronik është duke u zhvilluar sipas planit të paraparë, ku gjatë periudhës raportuese në mënyrë elektronike kanë deklaruar gjithsej 443. Gjithashtu janë përgatitë të gjitha elementet për deklarimin elektronik të llojit të tatimit TVSh, për të gjithë deklaruesit e TVSh-së.

Gjatë periudhës raportuese është vazhduar me zbatimin e Strategjisë së Përmbushjes 2012-2015, ku ka pas progres në ngritjen e performancës së të hyrave. Është bërë Segmentimi i Tatimpaguesve sipas kriterëve të parapara në Strategjinë e Përmbushjes 2012-2015 dhe kemi filluar me trajtimin e rreziqeve sipas Planit të detajuar të rreziqeve. ATK ka ndërtuar planin për ngritjen e kualitetit të komunikimit me publikun dhe tatimpaguesin, ku janë përfshirë :

Seminare, njoftime, komunikata, tryeza dhe forma të tjera të ofrimit të shërbimit në zyrat e edukimit të tatimpaguesve.

#### **3.1.4. Prokurimi Publik**

Pas miratimit të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042 me 05 Tetor 2011, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka aprovuar të gjitha Aktet dytësore të nevojshme për implementimin e Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.

Me aprovimin e 60 pjesëve të akteve dytësore në muajin janar 2012, aktet tjera në kuadër të legjislacionit sekondar që bëjnë të mundur kompletimin e legjislacionit sekondar në këtë fushë janë aprovuar në tërësi dhe kanë hyrë në fuqi në mars 2012. Me miratimin e Akteve Dytësore janë miratuar edhe Plani për menaxhimin e kontratës dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, ku gjinden rregullat në detaje për monitorimin e menaxhimit të kontratës. Deri më tani janë bërë dy Monitorime të Menaxhimit të Kontratës.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, me 7 mars ka filluar edhe programi themelor i trajnimit dhe certifikimit të zyrtarëve të prokurimit publik. Trajnimi do të zgjasë të paktën 15 ditë dhe pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe testimit, pjesëmarrësit do të marrin certifikatën themelore profesionale të prokurimit të vlefshme për vitet 2012-2014. Kurse, në ngritjen e kapaciteteve kadronike në kuadër të KRPP-së, nga 4 janari kanë filluar punën dy ekspert të ri ligjor.

Ka filluar faza e dytë e projektit: Trajnimi në Prokurimin Publik në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, projekt i financuar nga KE dhe që implementohet nga Konzorciumi ITCILO dhe ADETEF. Trajnimet janë duke i vijuar 26 pjesëmarrës nga Kosova. Nga perioda 01.03-31.03.2012, janë përfunduar monitorime në 4 Autoritete si monitorime të rregullta si dhe 4 monitorime të Autoriteteve sipas rastit. Janë përfunduar 52 monitorime me qëllim të përmirësimit të njoftimeve të publikuara në Ueb faqen e KRPP-së, të autoriteteve kontraktuese.

Për periudhën raportuese Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) ka pranuar gjithsejtë 57 ankesa të operatoreve ekonomik. Prej 57 ankesave të OE, 32 janë shqyrtuara nga OSHP-ja, kurse 25 janë në shqyrtim e sipër. Ndërsa, 30% të ankesave kanë shkuar në favor të operatoreve ekonomik, kurse në favor të Autoriteteve kontraktuese 26%.

#### **3.1.5. Punësimi dhe Politikat Sociale**

Sa i përket zhvillimeve në fushën e legjislacionit sekondar më 21 janar 2012 është miratuar UA nr.01/ 2012 për sistemin e punëve të lehta dhe të rënda për personat nën moshën 18 vjeç.

Po ashtu, është instaluar Sistemi i Informatave në Tregun e Punës në të gjitha shërbimet publike të punësimit, ky paraqet një sistem i cili bazohet në mbledhjen e të dhënave lidhur me tregun e punës. Ndërsa, Sistemi i Informatave për Menaxhimin e Punësimit nënkupton sistemin informativ për Menaxhimin e Punësimit dhe është funksional për regjistrimin e punëkërkuarve dhe menaxhimin e punësimit. Përmes këtij sistemi deri tani janë regjistruar 264.984 punëkërkuar. SIMP-i është funksionalizuar në të gjitha shërbimet publike të punësimit.

Grupi Punues i MPMS-së për zhvillimin e negociatave në mes Kosovës me shtetet e rajonit dhe të BE-së në fushën e Marrëveshjeve Bilaterale për Sigurime Shoqërore - Sigurimin Pensional e Invalidor ka vazhduar me takimet e radhës ku me 27 shkurt deri më 02 mars 2012 në Prishtinë janë zhvilluar negociatat ndërmjet zyrtarëve të Austrisë dhe Republikës së

Kosovës mbi përgatitjen e një marrëveshje të re Austriako- Kosovare në fushën e sigurimeve sociale. Kjo është si rrjedhojë e negociatave të mbajtura në Vjenë me 23-26 maj 2011.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale TEIP ka organizuar dhe ka realizuar trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë ku kanë marrë pjesë gjithsejtë 48 inspektorë të punës

Plani i Veprimit i Strategjisë Sektoriale për Shëndetësi është ndryshuar sipas rekomandimeve të DPSA dhe Raportit të Progresit.

*Sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore për komunitetin RAE, fushata e vetëdijesimit mbi rreziqet shëndetësore nga kontaminimi me plumb ka përfunduar me afatin e caktuar por implementimi i saj është në vazhdimësi si një domosdoshmëri për parandalimin e ekspozimit ndaj plumbit në gjak. Lidhur me këtë gjithashtu është përpiluar doracak për trajnim të punëtorëve shëndetësor siç janë: psikologët, sociologët, pedagogët dhe anëtarët e komunitetit që do të ofrojnë trajnime apo aktivitete brenda komunitetit e sidomos atyre personave që janë më të prekur nga kontaminimi me plumb dhe të marginalizuara lidhur me helmimin nga plumbi si dhe avokimin për çështjet shëndetësore.*

Raporti vlerësues mbi shkallën e kontaminimit është i përfunduar por për shkak të specifikës së kontaminimit raporti përditësohet sipas vlerave të gjetura në terren. Në këtë periudhë personat që janë trajtuar janë 13 gjithsej, 11 të rritur 2 fëmijë, 3 prej tyre janë në ritrajtim si pasojë e efektit re-bound (mos dhënia e efektit-indikacionit ndaj terapisë së përshkruar) gjatë trajtimit është duke u aplikuar protokollin e trajtimit i miratuar nga MSh. Numri i matjeve të nivelit të plumbit për këtë periudhë ka qenë 467 matje prej tyre 154 kapilare dhe 313 venoze. Gjithashtu, mund të themi që Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë ka terapi të mjaftueshme për trajtimin e personave me nivele të ngritur të Pb, BI 45cg/dl.

Aktivitetet e ndërmarra me qëllim të integritetit të komuniteteve në sistemin shëndetësor përbëheshin nga takimet me Drejtorët e Shëndetësisë të komunës së Shtërpcës dhe Graçanicës i cili është mbajtur me 24 shkurt 2012 me qëllim të përcaktimit të modaliteteve të financimit në shëndetësi. Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike të Kosovës ka filluar zbatimin e projektit për përfshirje të komunitetit REA në sistemin shëndetësor dhe ofrimi i shërbimeve në komunitet, ky projekt është në vazhdimësi dhe kohë pas kohe do të raportohet për të dhënat e reja. Gjithashtu moduli për evidentimin e Statistikave shëndetësore është funksionalizuar si dhe janë ndarë 234 specializime të reja.

### **3.1.6. Arsimi dhe Hulumtimi**

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik 2010-2015 për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar, gjatë periudhës raportuese janë punësuar 14 edukatorë dhe mësues të arsimit gjithëpërfshirës në 14 institucione arsimore, 7 edukatorë në institucione parashkollore dhe 7 mësime dhënë në shkollat fillore. Nga janari i vitit 2012 numri i institucioneve arsimore gjithëpërfshirëse ka arritur në 21, prej tyre 7 institucione parashkollore dhe 14 shkollat fillore. Janë pajisur dhe funksionalizuar me teknologji informative (TIK) 2 qendra burimore dhe një shkollë fillore gjithëpërfshirëse.

Ngritja e kapaciteteve të mësime dhënëse ka vazhduar, ku janë trajnuar rreth 6,000 mësime dhënëse në programin ECDL. Rreth 40 mësime dhënëse janë trajnuar në programe të ndryshme të TIK-ut.

Janë mbajtur 2 sesione informuese dhe trajnime për programin FP7, ku kanë marr pjesë rreth 100 pjesëmarrës (hulumtues, përfaqësues të institucioneve qeveritare, përfaqësues të bizneseve, etj).

MASHT ka themeluar Komisionin për reformimin e fakulteti të Edukimit të përbërë nga zyrtar të MASHT-it, Universitetit të Prishtinës (UP) dhe Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA).

MASHT-i me ndihmën e SWAP-it ka definuar profilin e mësimdhënësit kosovar dhe ka zhvilluar standardet për këtë profil, qe janë të krahasueshme me standardet në vendet evropiane dhe më gjerë.

Prej 20 deri 24 shkurt 2012 në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren dhe Pejë janë mbajtur 5 punëtori për sigurimin e cilësisë rajonale organizuar nga Agjencia për Kualifikime Kombëtare (AKK) me mbështetjen e Këshillit Britanik me sigurimin e një eksperti të jashtëm për sigurim të cilësisë. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte vazhdimi i implementimit të sigurimit të cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP), rishikimi i raporteve të vetëvlerësimit, planeve zhvillimore të institucioneve, planet e përmirësimit dhe sfidat për vitin 2011 si dhe përgatitja për vitin 2012 në aspektin e sigurimit të cilësisë në AAP.

Në kuadër të zbatimi të Programit të Trajnimit dhe Licencimit të Mësimdhënësve të Arsimit Parauniversitar gjatë kësaj periudhe raportuese janë trajnuar 3% të mësimdhënësve.

Biblioteka Kombëtare Universitete, dhe Institutet Kërkimore Shkencore (Universitet Publike dhe Institute Albanologjik dhe të Historisë) janë abonuar në bibliotekën elektronike EBSCO.

## **3.2. Politikat Sektoriale**

### **3.2.1. Industria dhe NVM-të**

Ne muajin shkurt 2012 është bërë rifreskimi i Aktit Evropian për Biznese të Vogla në Kosovë i cili është dërguar në Komision Evropian.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese janë arritur të nënshkruhen 12 kontrata të reja dhe 4 kontrata për zgjerim hapësire nga bizneset ekzistuese, andaj në numrin total të vendosura në Parkun e Biznesit në Drenas janë 33 biznese me vlerë totale të investimeve rreth €30 milion të deklaruar dhe me numër të punëtorëve afër 1000 të deklaruar nga ana e bizneseve. Nga gjithsej 33 biznese të vendosura në PBD, 26 biznese janë vendore, 2 biznese janë investime të jashtme dhe 5 biznese janë bashkë investim vendor dhe të huaj.

### **3.2.2 Bujqësia dhe Peshkataria**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë miratuar tri Ligje:

- Ligji nr 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më nr. 26, më datën 25 nëntor 2011;
- Ligji nr 04/L-040 për Rregullimin e Tokës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me nr 03, më datën 22 shkurt 2012;
- Ligji nr 04/L-074 për Shërbime Këshillimore, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më nr 04, me datën 19 mars 2012.

Sa i përket krijimit të sistemit të thjeshtëzuar të parcelave të tokës (LPI-s) është funksionalizuar programi softuerik i cili është përdorur gjatë aplikimit të fermerëve për sipërfaqe për pagesa direkt për kulturën e grurit si dhe janë digjitalizuar 37,452 parcela të 9,575 fermerëve. Po ashtu është themeluar edhe programi softuerik për Regjistrin e fermave. Për këtë periudhë janë regjistruar 15,740 fermer, janë përgatitë masat teknike, rregulloret, thirrjet për aplikim dhe materiali tjetër informues për programin vjetor për bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2012.



Është përgatitur Pyetëtori dhe Udhëzuesi për grumbullimin e të dhënave për FADN për "Librin e Fermës" si dhe janë grumbulluar të dhënat për çmimet absolute të produkteve bujqësore. Po ashtu është bërë analizimi i të dhënave statistikore bujqësore (import-eksport) në mes të Kosovës dhe BE Në lidhje me avancimin e shërbimeve këshillimore, janë zotuar mjetet në shumë prej 200,000.00 Euro, si dhe janë përgatitë Termat e Referencës për projektin "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshillimore".

Sa i përket inventarizimit nacional të pyjeve është përgatitë udhëzuesi për mbledhjen e të dhënave në terren në të tri gjuhët. Është bërë klasifikimi i sipërfaqeve provë prej 1,879.00 ha. Në lidhje me mbrojtjen e pyjeve, janë ngritur 624 fletëparaqitje për kundërvajtje për dëmin e shkaktuar prej 899.19 m<sup>3</sup> masë drusore dhe 274 fletëparaqitje penale për dëmin e shkaktuar prej 1,131m<sup>3</sup> mase drusore. Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në bashkëpunim me projektin "Norëegian Forest Group" e ka përgatitur udhëzuesin për trajtimin e pyjeve cungishte të reja, për pyllëzimet, për rrugët pyjore si dhe është botuar udhëzuesi i dytë për silvikulture.

Sa i përket hartimit të planeve menaxhuese dhe pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura, është bërë plani menaxhues për 25,706.38 ha. Për pyllëzimin e pyjeve të zhveshura, janë caktuar lokacionet për pyllëzime si dhe janë siguruar 1,200,000.00 fidanë në Institutin e Pylltarisë në Pejë.

### **3.2.3. Siguria e Ushqimit dhe Veterinaria**

Në fushën e operacionalizimit të mëtejme të infrastrukturës së TI- së për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve janë raportuar 3,150 lëvizje të gjedheve, 4,011 të lëvizjeve të deleve, dhive dhe derrave. Sa i përket raportimeve të reja (imatrikulimet për herë të parë) gjatë kësaj periudhe janë raportuar: gjedhe 22,552, dele 5,625, dhi 1,772 dhe derra 1,800.

Po ashtu janë raportuar nga thertoret 467 therrje të kafshëve të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe inspektorët veterinar kanë vizituar tregjet e kafshëve brenda territorit të Kosovës dhe kanë identifikuar menaxheret e këtyre tregjeve dhe deri më tani kanë pranuar 10 aplikacione për licencimin e tregjeve të kafshëve.

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë ka rekrutuar 3 punëtorë për fushat: Dy pozita janë për Kimist, ndërsa e treta Zyrtar të kontrollit të cilësisë.

### **3.2.4. Mjedisi**

Me qëllim të plotësimit të kornizës ligjore, për këtë periudhë raportuese MMPH me datë 28.02.2012, ka miratuar UA Nr.14/2012, për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim.

Në vazhden e realizimit të projekteve për mbrojtjen e mjedisit, me 31 mars janë lëshuar në funksion 7 stacione monitoruese për cilësinë e ajrit. Për më tepër, ka përfunduar Studimi i fizibilitetit për sistemin e inventarit të gazrave serë.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve institucionale Agjencionit për Siguri Nukleare dhe Mbrojtje nga Rrezatimi iu është nda buxheti prej 28,000 € për vitin 2012.

MMPH me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve për vetëdijësim mjedisor dhe për çështje tjera mjedisore me shoqërinë civile, me datë 02.03.2012 ka nënshkruar Memorandumin e bashkëpunimit në mes të AMMK-së dhe iniciativës mjedisore "Ta pastrojmë Kosovën" e përfaqësuar nga OJQ "Liria". Mbi këtë qëllim, MMPH ka mbajtur debate publike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, për 140 pikat e telefonisë mobile IPKO. Debatet janë mbajtur në këto rajone: në Mitrovicë me 09.01.2012; në Prizren me 08.02.2012; në Pejë me 20.02.2012 dhe në Prishtinë me 13.02.2012.

Në vazhden e ngritjes së kapaciteteve njerëzore, në kuadër të projektit RENA janë mbajtur dy trajnime: 1. Me 24-25 janar 2012 në Tiranë, Shqipëri është mbajtur punëtorja për Planifikimin e investimeve mjedisore në kuadër të GP 1 (Planifikimi Strategjik i Investimeve) ku kanë marrë pjesë 3 zyrtarë. Më 28.02.2012 deri 01.03.2012 në Shkodër, Shqipëri është mbajtur trajnimi për monitorimin e ujerave sipërfaqësor dhe nëntokësor ku kanë marrë pjesë 4 zyrtarë. Me datë 05-09.03.2012 është mbajtur trajnimi për Promovimin e Qendrave të Kompetencës në kuadër të reformimit të AAP në Kosovë ku nga MMPH është trajnuar një zyrtar. Gjithashtu, MMPH ka marrë pjesë në trajnimin për Mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe masat kundër ngrohjes globale në Japoni me datë 01-17.03.2012.

### **3.2.5. Politikat e Transportit**

Në kuadër të zbatimit të memorandumit të mirëkuptimit në Evropën juglindore për zhvillimin e një rrjeti bazë për transport, Kosova ka marrë pjesë aktive në takimet e organizuara nga Observatori i Transportit të Evropës Juglindore (SEETO), gjegjësisht në takimin e Komitetit Drejtues më 13 mars 2012 në Tiranë.

Në vazhden e implementimit të projektit të R7, kanë përfunduar punët tokësore në gjatësi prej 4 km në segmentin 4b, ndërkaq punimet kanë përfunduar në masën 80% në urën nr. 12. Më tej, në segmentin 5 është bërë hapja e trasës në gjatësi prej 15 km duke përfshirë përfundimin e tërësishëm të punimeve sa i përket mbikalimit. Ndërkaq sa i përket objekteve (strukturave) përcjellëse në këtë segment, punimet janë realizuar në masën 60%.

Për më tepër, në fushën e mirëmbajtjes së rrugëve, gjegjësisht implementimit të programit të mirëmbajtjes dimërore të rrjetit të rrugëve nacionale dhe regjionale, janë mirëmbajtur, përkatësisht pastruar nga dëborë 2000 km rrugë.

Ndërkaq, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të rrjetit ekzistues të transportit rrugor ndërrurban dhe subvencionim të transportit i cili është ekonomikisht i paqëndrueshëm, janë pajisur me licencë 3 operatorë të transportit të udhëtarëve si dhe janë nënshkruar 2 kontrata në transportin humanitar (subvencionuar).

Sa i përket trajnimeve profesionale, janë trajnuar dhe certifikuar 17 shofer me certifikatë për transport të mallrave të rrezikshme (ADR-s), si dhe janë trajnuar 210 shofer për kompetencë profesionale (CPC) sipas standardeve të Unioni Ndërkombëtar të Rrugëve (IRU-s).

### **3.2.6. Energjia**

Sa i përket zhvillimeve drejt kapaciteteve të reja gjeneruese, janë finalizuar Kërkesa për Propozime dhe Marrëveshjet e Projektit "Kosova e Re" si dhe janë aprovuar nga Komiteti Drejtues i Projektit me datë 06 mars 2012.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit nr.04/L-016 për Eficiencën e Energjisë është miratuar

- Rregullorja për themelimin dhe funksionimi e komisionit për certifikim të Auditoreve dhe Menaxhereve të energjisë është miratuar me datë 26.01.2012, dhe
- UA për Auditimin e Energjisë miratuar nga Qeveria dhe shpallur në gazetën zyrtare me datë 30.01.2012.

Drejt përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së kapaciteteve transmetuese dhe transformuese KOSTT sh.a. në Rrjetin e Transmisionit 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, gjatë kësaj periudhe ka implementuar:

- Zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë të NS 220/110 kV Prizreni 2 dhe është instaluar transformatori i tretë (TR3) 150MVA;
- Janë ndërruar mbrojtjet rele të NS Prishtina 2 dhe NS Prishtina 3.

Lidhur me sigurimin me furnizim me energji, nga miniera e Sibovcit Jug-Perëndimor KEK sh.a gjatë periudhës raportuese ka kryer këto aktivitete:

- Largimin e 2,043,776 m<sup>3</sup> djerrinë dhe prodhimin e 1,498,249 t qymyr për TC Kosova A dhe B,
- Riparimi i shiritave transportues të qymyrit B- 1600, dhe është duke u bërë montimi i shiritave;
- Riparimi i ekskavatorit E 7M dhe shiritat vetëlëvizës janë është lëshuar në punë dhe është në fazën testuese.

Sa i përket përforcimit dhe rehabilitimit të rrjetit shpërndarës është bërë zgjerimi i TS 110/35 kV në Palaj, pranimit teknik dhe lëshimi në punë. i TS 110/35 kV.

Po ashtu ka pasur zhvillime edhe drejt përmirësimit të matjeve të energjisë elektrike, siç është vendosja e 5,721, nga gjithësejt 50.000, njehsorëve multifunksional tek konsumatorët shtëpiak.

### **3.2.7. Shoqëria Informative dhe Media**

Saj përket zhvillimeve legjislativë, ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike është miratuar nga Kuvendi më datë 15 mars 2012 dhe tanimë Ligji No. 04/L-094 është i publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 6 të datës 11.04.2012. Gjithashtu, ligji për Komunikimet Elektronike është miratuar nga Qeveria më datë 01 shkurt 2012, ndërsa ka kaluar leximin e parë në Kuvendi më 15 mars 2012.

Po ashtu, në kuadër të avancimit dhe kompletimit të kornizës primare legjislativë në fushën e lirisë së shprehjes dhe medieve, me 2 mars 2012 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin (nr. 04/L-44) për Komisionin e Pavarur të Medieve, ndërsa me 29 mars 2012 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin (nr. 04/L-46) për Transmetimin Publik në Kosovë.

Me qëllim të mbështetje se medieve minoritare dhe të tjera, në kuadër të *Fondit për Mbështetje të Medieve Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta*, Qeveria e Kosovës ka ndarë shumën prej 80,762 € me ç'rast 15 medime minoritare, multietnike dhe media të grupeve të veçanta kanë përfituar nga ky fond.

Në kuadër të përpjekjeve të kompletimit të kornizës sekondare legjislativë, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) me 19 mars 2012 ka miratuar rregulloren për "Drejtën për Shteg dhe Shfrytëzimin e përbashkët të Infrastrukturës" (nr.Prot.030/B/12). Ndërkaq, sa i përket zhvillimeve në fushën e analizave të tregut, ka përfunduar analiza e tregut të telefonisë fikse. Po ashtu, ART ka miratuar 7 vendime për definim të tregut si dhe 8 vendime për operatorë me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT).

### **3.2.8. Kontrolli Financiar**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve është bërë trajnimi i dhjetë auditorëve të brendshëm nga niveli lokal me temën " Bazat e auditimit të brendshëm".

Janë rekrutuar dy auditor të brendshëm. Janë realizuar dy vizita me qëllim që t'i ndihmohet menaxhmentit në krijimin e funksionit të auditimit të brendshëm (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Avokati i Popullit).

Sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit të organizatave buxhetore gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe aranzhuar Pyetësi Vetë Vlerësues (PVV) të MFK-së. Janë mbledhë shënime nga OB dhe sistemuar në databazën e informatave. Është bërë sistemimi

dhe analizimi i të dhënave. Këta pyetësorë ju janë dërguar 91 OB, 74 OB janë përgjigjur në përqindje 83%.

Gjithashtu janë pranuar dhe rishikuar 58 raporte nga NJAB.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve Zyra e Auditorit Gjeneral ka rekrutuar 6 auditorë të rijnë. Ka filluar projekti për të përafruar skemën e certifikimit me standardet e azhuruara të ISSAI. Rreth 80 memo të auditimit u janë dorëzuar entiteteve nën auditim. Këto memo paraqesin këshillat e drejtorëve të auditimit dhe mënyrën se si janë adresuar rekomandimet e dhëna më herët. Gjatë kësaj periudhe ZAGJ ka lëshuar dy raporte të veçanta të auditimit për projekte të financuara nga donatorët.

Është publikuar raporti i auditimit për Programin për Investime Publike që ka të bëjë me efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e sistemit të PIP-it.

### **3.2.9. Statistikat**

Me aprovimin e ligjit për Statistika tani më ky Institucion do të jetë në kuadër të ZKM-së si Agjencia për Statistika të Kosovës (ASK), dhe në përputhje me ligjin e ri është duke u bërë ristrukturimi i ASK në tërësi.

ASK deri në fund të muajit prill ka përfunduar analizimin dhe publikimin e: të dhënave të mirëqenies sociale për vitin 2011; analizimin dhe publikimin e të dhënave të statistikave të sportit për vitin 2010; indeksi i çmimit të konsumit; statistikave të tregtisë së jashtme etj.

Janë zhvilluar disa fusha të reja tek statistikave ekonomike përfshirë këtu anketën tremujore për ndërmarrje të industrisë dhe ndërtimitarisë, raportin për statistika të transportit të publikuar në shkurt 2012, statistikave tremujore për hoteleri, energji, indeksi i çmimeve të prodhimit dhe importit. Në lidhje me statistikave të biznesit, është në fazën përfundimtare Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN) që është bazë për përpilimin e Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas qasjes prodhuese.

ASK në kuadër të projektit të regjistrimit të popullsisë ka bërë pastrimin e të dhënave në databazë duke kaluar fazën e editimit, inputimit, redaktimit dhe ka përfunduar planin e tabelimit.

## **3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA**

### **3.3.1. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi**

Për të mundësuar zbatimin e Ligjit për Gjendjen Civile me 3 shkurt janë miratuar gjithsej pesë UA: UA për Vulat Apostile nr 01/2012; UA për Regjistrimet e Mëvonshme nr 02/2012; UA për Ri-regjistrimet nr 03/2012; UA për Numrin Personal nr 04/2012 dhe UA për Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave nr. 05/2012.

Në fushën e menaxhimit të kufijve, është bërë nënshkrimi i dy protokolleve me Republikën e Shqipërisë: Protokollin për patrullime të përbashkëta kufitare; dhe Protokollin për takimet e rregullta kufitare në nivel nacional, rajonal dhe lokal. Me Republikën e Shqipërisë janë mbajtur 8 patrullime të rregullta mujore ndërsa me atë të Maqedonisë 4 patrullime në muaj. Me Serbinë është nënshkruar Protokollin për kontrollin e përbashkët kufitar të gjashtë pikave kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë.

Gjatë kësaj periudhe, janë digjitalizuar gjithsej 1,114 regjistra civil dhe janë prodhuar gjithsej 42,500 pasaporta biometrike.

Në fushën e migrimit dhe azilit vlen të theksohet se më datën 6 shkurt 2012 është inauguruar dhe funksionalizuar Qendra e Përhershme e Azilkërkuesve në Magurë të Komunës së Lipjanit. Ndërsa me 18 prill Qeveria ka themeluar Komisionin për Refugjatë ne përbërje prej 7 anëtarëve. Gjatë periudhës raportuese janë ri-pranuar 965 persona dhe janë pranuar 14 kërkesa për azil. Në këtë periudhë raportuese janë mbajtur gjithsej tri trajnime: një trajnim (kurs) i gjuhës angleze, një trajnim mbi të drejtat e refugjatëve dhe një trajnim për pajisje biometrike, ku janë trajnuar gjithsej 7 zyrtarë të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim.

Sa i përket fushës së ri-integrimit për vitin 2012 janë alokuar gjithsej 3,170,150.00 euro. Numri i kërkesave të pranuar për përfitim nga Fondi për Ri-integrim për këtë tremujor ishte 612, prej të cilave 541 janë aprovuar, ndër to janë aprovuar 66 kërkesa për plan biznese. Në lidhje me sensibilizimin e qytetarëve rreth migrimit ilegal, ka vazhduar fushata mediale e filluar në vitin 2011 dhe shpërndarja e broshurave nëpër komuna, aeroport dhe në pikat e kalimit kufitar.

### **3.3.2. Pastrimi i Parave**

Në mënyrë që të përmirësohet më tutje sistemi i funksionimit të IT-së, në fund të 2011-ës, janë investuar 69,960.71 euro dhe tani softueri operon me kapacitet 30% më të lartë dhe RAM memoria është rritur për 50%. Gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 6 analistë në fushat e hetimeve financiare si: Pastrimi i parave bazuar në tregti dhe Teknikat e analizave financiare. Janë mbajtur edhe trajnime tjera si: trajnimi i avancuar mbi luftën e krimit ekonomik dhe trajnimi me temën Ligji mbi parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimi i terrorizmit. Gjithsej, për këtë periudhë të vitit janë raportuar 9 raste të mos deklarimit të mjeteve monetare në kufi.

### **3.3.3. Policia dhe Luftimi i Krimit të Organizuar**

Është bërë monitorimi i parë i implementimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës për periudhën gjashtëmujore gusht-dhjetor 2011. Në bazë të këtij monitorimi del se nga gjithsej 218 veprime për t'u ndërmarrë nga institucionet e cekura në plan të veprimit, 26 aktivitete apo 11.87% kanë përfunduar, 28 aktivitete apo 12.84 pothuajse kanë përfunduar, 97 aktivitete apo 44.49% janë në proces, 16 aktivitete apo 7.33% janë kryer pjesërisht, dhe 51 aktivitete apo 23.39% nuk janë raportuar nga institucionet. Këshillat komunale për Sigurinë në Komunitet në komunat e reja (Novobërdë, Kllokot, Junik, Mamushë, Graçanicë, Partesh dhe Ranilluk) janë tërësisht funksionale.

Për më tepër, në mars 2012 ka përfunduar rekrutimi i 8 zyrtarëve në Departamentin për Siguri Publike në MPB. Në këtë periudhë është bërë gjithashtu përcaktimi dhe rrethimi i ngastrës për ndërtimin e depos së eksplozivëve komercial.

Në fushën e luftimit të krimit të organizuar janë trajnuar gjithsej 11 zyrtarë për hetime, ndërsa një prokuror nga prokuroria speciale ka marrë pjesë në trajnimin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve në fushën e luftimit të krimit të organizuar, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 3 trajnime të ndryshme: për krimet kibernetike; për konfiskimin e pasurisë dhe kundër pastrimit të parave ku janë trajnuar gjithsej 31 zyrtarë policor.

Duke përfillur procedurat standarde të operimit dhe procedurat tjera ligjore janë shkatërruar gjithsej: rreth 1kg e 700 gr heroinë, 28gr kokainë, rreth 20 kg marihuanë, 325 fije kanabis sativa dhe rreth 33 kg substanca të dyshuara narkotike (droga tjera). Janë iniciuar gjithsej 135 raste, janë arrestuar 192 persona të dyshuar dhe janë konfiskuar: 31 kg heroinë, 118 kg marihuanë, 3 kg e 100gr sasi e dyshuar kokainë, 61 tableta ekstazë, 241 fije canabis sativa, 3100 fara cs., 131 bimë Papaver somniferum. Janë kryer gjithsej 63 bastisje, 8 plane operative dhe janë zhvilluar 52 operacione, me ç'rast janë identifikuar gjithsej 16 grupe kriminale.

Lidhur me luftën kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore ka zhvilluar 32 operacione policore, të cilat kanë rezultuar me 49 arrestime, prej tyre 29 për TQNJ dhe 20 për vepra që ndërlidhen me trafikim. Janë shpërbërë 3 grupe kriminale, ndërsa janë identifikuar 18 viktima të trafikimit. Sa i përket trajnimeve, 5 prokuror të Prokurorisë së Qarkut kanë marrë pjesë në trajnime në temat mbi rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Për më tepër janë mbajtur gjithsej 4 trajnime për stafin policor, ku janë trajnuar 27 zyrtarë, si dhe janë rekrutuar 26 zyrtarë të rinj.

Sa i përket fushës së mbrojtjes dhe sigurisë së dëshmitarëve janë mbajtur 6 trajnime për 4 zyrtarë dhe është realizuar pjesëmarrja në dy konferenca rajonale për mbrojtjen e dëshmitarëve.

#### **3.3.4. Mbrojtja e të dhënave personale**

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, me 4 prill 2012 është miratuar UA për kartelat zyrtare të mbikëqyrësve shtetëror, si dhe janë nxjerr një sërë aktesh: akti/forma e ankesës për subjekte dhe kontrollues të të dhënave personale, akti/forma e procesverbalit të punës në terren për pjesë operacionale, akti/forma e formularit për transfer të të dhënave personale jashtë vendit, si dhe lista e standardizuar për pyetje në terren për mbikëqyrësit gjatë inspektimit dhe kontrollit.

Sa i përket bashkëpunimit me vendet tjera, ASHMDHP ka nënshkruar marrëveshje bilaterale të bashkëpunimit me Republikën e Malit të Zi në janar 2012 si dhe me Republikën e Sllovenisë në mars 2012. Për më tepër, kjo Agjenci, në kuadër të aktiviteteve për ngritje te vetëdijes së qytetarëve në këtë fushë, ka organizuar punëtorinë me temën: "Mediet dhe Privatësia".

**Aneks I - Ligjet e Miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi**

**Zyra e Kryeministrit**

**LIGJET:**

**PROJEKTLIGJET:**

**AKTET NENLIGJORE:**

**Ministria e Administratës Publike**

**LIGJET:**

**Ministria e Drejtësisë**

**PROJEKTLIGJET:**

**AKTET NENLIGJORE**

**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**

**LIGJET:**

**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

**PROJEKTLIGJET:**

**AKTET NËNLIGJORE:**

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

**LIGJET:**

**PROJEKTLIGJET:**

**Ministria e Punëve të Brendshme**

**LIGJET:**

**PROJEKTLIGJET:**

**AKTET NËNLIGJORE:**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**LIGJET:**

**PROJEKTLIGJET:**

**AKTET NËNLIGJORE:**

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**AKTET NËNLIGJORE:**

**Ministria e Financave**

**LIGJET:**

**Ministria e Punëve të Jashtme**

**LIGJET:**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

**PROJEKTLIGJET:**

**AKTET NËNLIGJORE:**

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik**

**LIGJET:**

**AKTET NËNLIGJORE:**

**Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës**

**LIGJET:**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

**LIGJET:**

**Ministria e Infrastrukturës**

**LIGJET:**

**Tabela 1: BPV nominale dhe rritja reale e saj**

Pershkrimi	2007	2008	2009	2010	2011 Vler.
<i>Ne miliona euro</i>					
<b>Konsumi</b>	<b>3,811</b>	<b>4,345</b>	<b>4,280</b>	<b>4,531</b>	<b>4,982</b>
<b>Investimet</b>	<b>893</b>	<b>1,094</b>	<b>1,166</b>	<b>1,369</b>	<b>1,540</b>
<b>Neto eksportet e mallrave dhe sherbimeve</b>	<b>-1,309</b>	<b>-1,587</b>	<b>-1,534</b>	<b>-1,710</b>	<b>-1,916</b>
<b>BPV</b>	<b>3,394</b>	<b>3,851</b>	<b>3,912</b>	<b>4,190</b>	<b>4,605</b>
<b>Rritja reale e BPV, në %</b>	<b>6.3%</b>	<b>6.9%</b>	<b>2.9%</b>	<b>3.9%</b>	<b>5.3%</b>
<b>IÇK</b>	<b>4.5%</b>	<b>9.2%</b>	<b>-2.4%</b>	<b>3.5%</b>	<b>7.3%</b>

Burimi: ASK dhe parashikimet e Departamentit të Makroekonomisë, MF

Metodologjia e përdorur për kalkulimin e rritjes reale është ndryshuar në pajtim me metodologjinë e përdorur nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK). Rritjet për vitet 2007-2010 janë kalkuluar nga ASK, duke paraqitur rritjen reale në krahasim me vlerën nominale të vitit paraprak. Me të njëjtën metodologji është bërë edhe vlerësimi i rritjes reale për vitin 2011 dhe vitet vijuese nga ana e Ministrisë së Financave. Parashikimi është rifreskuar bazuar në të dhënat e fundit të publikuara nga ASK dhe BQK.

**Tabela 2: Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm, në miliona euro dhe si % në GDP<sup>1</sup>**


Pershkrimi	2008		2009		2010		2011	
	ne mil. euro	ne % te BPV-se	ne mil. euro	ne % te BPV-se	ne mil. euro	ne % te BPV-se	ne mil. euro	ne % te BPV-se
Bilanci Tregtar	-1,668	-43.3	-1,652	-42.8	-1,752	-41.8	-2,059	-44.7
Eksportet	198.5	5.2	177.2	4.2	305.0	7.3	325	7.1
Importet	-1,867	-48.5	-1,829	-47.0	-2,057	-49.1	-2,384	-51.8
Sherbimet neto	81.1	2.1	194.5	3.4	144.0	3.4	281.3	6.1
Te hyrat neto	164.8	4.3	83.0	2.3	61.0	1.5	114.6	2.5
Transferet neto	794.4	20.6	983.4	19.7	962.5	23.0	948.1	20.6
nga te cilat: remitancat	449.7	11.7	475.3	10.1	485.1	11.6	489.3	10.6
Bilanci i llogarise rrjedhese	-628.0	-16.3	-390.9	-17.4	-584.5	-14.0	-715.1	-15.5
Llogaria financiare dhe kapitale	462.8	12.0	213.2	13.7	341.9	8.2	553.3	12.0
Llogaria kapitale	10.4	0.3	100.3	2.8	21.3	0.5	31.0	0.7
Llogaria Financiare	475.5	12.3	112.9	8.5	320.6	7.7	522.3	11.3
nga te cilat: Investimet direkte	341.5	8.9	280.9	7.0	390.9	9.3	414.0	9.0
Mjetet Rezerve	-23.1	-0.6	94.3	2.4	-65.6	-1.6	59.8	1.3
Gabimet dhe leshimet	165.9	4.3	177.7	2.4	242.6	5.8	161.8	3.5

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

<sup>1</sup> Të dhënat e BQK për Bilancin e pagesave për periudhën Tetor 2011-Dhjetor 2011 janë publikuar në fillim të muajit prill dhe përfshinë disa ndryshime andaj edhe mund të ketë mospërputhje me në mes të tabelës 1 dhe tabelës 2 në zërin e eksportit të mallrave dhe shërbimeve.



**Grafiku 1: Ndryshimi vjetor në % i IÇK dhe në IÇK bazë (Core Inflation)**



**Tabela 3: Normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale**

Indeksi	Përshkrimi	2011												2012
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar
NEER		100.9	101.1	100.6	101.3	100.9	101.0	101.0	101.1	101.1	101.2	101.2	101.1	100.9
REER (Total)		106.3	108.1	107.7	107.0	106.6	105.9	105.9	105.9	105.2	106.1	105.7	105.8	106.5
REER (CEFTA)		106.2	107.7	106.6	106.6	106.3	106.0	106.0	106.0	105.5	106.3	106.0	106.6	106.9
REER (EU)		108.2	110.0	110.1	108.1	108.1	107.2	107.1	107.0	106.2	107.0	106.8	106.9	108.2

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

**Tabela 4: Te hyrat dhe shpenzimet buxhetore te nivelit komunal dhe qendror Janar- Shkurt, 2012**

	Buxheti 2012 (SIMFK)	Gjithsej të Realizuara	2012		Progresi ndaj planit %
			Janar	Shkurt	
milion euro					
<b>Pranimet</b>					
Të Hyrat Tatimore	1120.06	132.07	69.07	63.00	12%
Tatimet Kufitare-Dogana	867.27	85.74	40.08	45.66	10%
Kthimet nga Dogana	-1.50	-0.19	-0.04	-0.15	13%
Tatimet Vendore-Administrata Tatimore	287.79	49.43	29.33	20.09	17%
Kthimet nga ATK-ja	-33.50	-2.90	-0.31	-2.59	9%
Të Hyrat jo tatimore- niveli qendror	48.09	5.72	3.39	2.33	12%
Të Hyrat Vetanake	123.40	16.97	10.27	6.70	14%
Niveli qendror	60.96	10.01	6.83	3.18	16%
Komunat	62.44	6.96	3.44	3.52	11%
Mbështetja buxhetore	30.00	0.72	0.72	0.00	2%
Pranimet nga emetimi i letrave me vlerë	74.00	19.82	9.91	9.91	27%
<b>Gjithsej pranimet</b>	<b>1,395.56</b>	<b>175.31</b>	<b>93.36</b>	<b>81.95</b>	<b>13%</b>
<b>Pagesat</b>					
Paga dhe mëditje	407.85	34.09	0.15	33.95	8%
Mallra dhe shërbime	176.12	22.16	5.07	17.10	13%
Shpenzime komunale	22.80	3.84	1.37	2.47	17%
Subvencione dhe transfere	281.90	34.53	16.01	18.52	12%
Shpenzime kapitale	616.88	82.57	7.43	75.14	13%
Rezerva	3.74	0.00	0.00	0.00	0%
Huaja e KEK-ut	15.00	1.05	0.07	0.97	7%
Borxhi i jashtëm	24.00	0.06	0.00	0.06	0%
<b>Gjithsej pagesat</b>	<b>1,548.29</b>	<b>178.30</b>	<b>30.09</b>	<b>148.21</b>	<b>12%</b>
<b>Balanci i Buxhetit</b>		<b>-2.99</b>	<b>63.27</b>	<b>-66.26</b>	

Tabela 5. Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV

Përshkrimi	2009	2010	2011
Konsumi privat	92.3%	91.2%	91.3%
Investimet Private	19.6%	21.8%	22.0%